



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 23, datë 26.02.2018

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK ONLINE TË SHITJEVE TË KONTRATAVE TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM MOTORIK”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 38, pika 1, germa c), pika 2 dhe 5, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Rregullorja nr. 3, datë 03.10.2007 “Për regjistrin elektronik online të shitjeve të sigurimit të detyrueshëm”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI